

POLITIKAT NË FOKUS: Krijimi i urave të bashkëpunimit mes institucioneve arsimore dhe sektorit privat



Rreth publikimit 'Politikat në Fokus'

'Politikat në Fokus' është publikim i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë që ka për synim të sjellë vëmendjen në politika të ndryshme ekonomike që ndikojnë në zhvillimin e sektorit privat në vend. Ky edicion i këtij publikimi vë fokusin në sektorin arsimor në vend, në mënyrë që të analizohet se sa institucionet arsimore kanë arritur që të krijojnë një fuqi punëtore që reflekton nevojat e sektorit privat, si dhe për të dhënë rekomandime se si të përmirësohet sistemi ekzistues i arsimit. Publikimi bazohet edhe në të dhëna të publikuara së fundi në një studim i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë që ka trajtuar boshllëkun e shkathtësive të fuqisë punëtore. Gjithashtu, ky dokument rishikon edhe strategjinë e sektorit të arsimit, si një dokument primar që duhet të shërbejë si udhërrëfyes për zhvillimin e sektorit në vitet në vijim.

Hyrje

Sektori arsimor është shtyllë tejet e rëndësishme e përpjekjeve për zhvillim ekonomik në vend. Përderisa pasja e një kornize të përshtatshme rregullative së bashku me një mjedis të favorshëm fiskal është një element shumë i rëndësishëm, qëllimi për të arritur një zhvillim ekonomik afatgjatë nuk do të arrihet apo nuk do të kishte ndikimin e kërkuar pa pasur një sistem arsimor të mirëfilltë. Në ekonomi, institucionet arsimore shihen si burimi kryesor për nxjerrjen e fuqisë së shkathët punëtore, që njëkohësisht paraqet inputin kryesor në të gjitha aktivitetet biznesore. Një fuqi punëtore e edukuar dhe e shkathët është burim i përparësisë konkurruese, dhe Kosova duhet të sigurohet që ka krijuar politikat e duhura që mundësojnë zhvillimin e fuqisë punëtore në përputhje me nevojat e sektorit privat.

Kosova vë theksin në fuqinë e lirë punëtore si përfitimi kryesor të cilët investitorët e huaj mund të

presin nga investimi i tyre në Kosovë. Kjo përparësi vihet në rrezik nëse kjo fuqi punëtore nuk zotëron shkathtësitë që sektori privat kërkon. Rrjedhimisht, institucionet duhet të zhvillojnë një sistem apo model në të cilën të diplomuarit nga institucionet arsimore kanë kompetencat e nevojshme.

Fatkeqësisht, një gjë e tillë nuk ka ndodhur në Kosovë deri tani. Një studim i publikuar së fundi nga Oda Amerikane tregon se në sektorin privat në Kosovë ka një boshllëk të ndjeshëm të shkathtësive të fuqisë punëtore. Ky boshllëk më së shumti ndihet në sektorët e prodhimit dhe shërbimeve, gjë që ndikon në konkurrueshmërinë e kompanive në nivel rajonal dhe global. Në masë të madhe, kompanitë duhet të organizojnë trajnime të posaçme që të adresojnë boshllëkun, veprim ky që krijon kosto shtesë për ta. Studimi përfshin një numër të madh të rekomandimeve, një pjesë e të cilave janë listuar në pjesë të mëvonshme të këtij publikimi.

Rishikim i Sektorit Arsimor në Kosovë

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) duhet të shfrytëzohet si dokument bazë për të gjitha zhvillimet në sektorin arsimor në vend. Strategjia përmban gjithsej 7 objektiva strategjike, ky secila prej tyre përmban disa rezultate të pritshme që duhet të arrihen gjatë kohës kur strategjia është në fuqi.

Vlen të theksohet se nevoja për të përmirësuar cilësinë e arsimit, si dhe nevoja për të krijuar lidhje më të mirë mes asaj se çka mësohet në shkollë dhe çka nevojitet në treg të punës përmenden si qëllime kyçe përgjatë dokumentit. Gjithashtu, strategjia ofron një shpjegim të detajuar të procesit për hartimin e kurrikulave për nivele të ndryshme të arsimit, si dhe informata për numrin e studentëve aktual dhe programeve të ofruara për të gjitha nivelet.

Objektivat Strategjike të PSAK 2017-2021

OS 1- Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja: Rritja e përfshirjes dhe mundësitë e barabarta për zhvillim, aftësim dhe arsimim të çdo individi në arsimin para-universitar.

OS 2- Menaxhimi i Sistemit Arsimor: Menaxhimi cilësor dhe efikas i sistemit të arsimit, i bazuar në transparencë dhe në llogaridhënie.

OS 3- Sigurimi i Cilësisë: Zhvillimi i një sistemi funksional për sigurimin e cilësisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

OS 4- Zhvillimi i Mësimdhënësve: Ngritja e cilësisë së mësimdhënies përmes sistemit efektiv dhe të qëndrueshëm për përgatitjen dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve

OS 5- Mësimdhënia dhe të nxënit: Avancimi i të nxënit përmes mësimdhënies cilësore, duke zbatuar kurrikulën e bazuar në kompetenca dhe duke shfrytëzuar resurse mësimore të cilësisë së lartë

OS 6- Arsimi dhe Aftësimi Profesional (AAP) dhe Arsimit për të Rritur (ARR): Harmonizimi i arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e tregut të punës në vend dhe më gjerë dhe krijimi i një sistemi të hapur të arsimit për të rriturit.

OS 7- Arsimi i Lartë: Ngritja e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë përmes nxitjes së përsosmërisë në mësimdhënie, kërkimit shkencor, krijimtarisë artistike, inovacionit dhe ndërkombëtarizimit.

Strategjia është vazhdimësi e një strategjie të mëhershme që ka mbuluar vitet paraprake, dhe sqaron sfidat e hasura në përmbushjen e objektivave të mëhershme.

Sa i përket objektivave strategjike, mund të thuhet se OS6 dhe OS7 janë me interes të veçantë për sektorin privat. Analiza e Boshllëkut të Shkathtësive ka treguar se boshllëqet më të mëdha hasen në profile profesionale që tradicionalisht ofrohen nga institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional (AAP). Gjetja e kuadrove për mirëmbajtjen e makinerive, kontrollimin e sigurisë në prodhim, inxhinieri të prodhimit etj. mund të jetë detyrë tejet e vështirë për kompani. Fatkeqësisht, institucionet e AAP në vend nuk kanë arritur të ndjekin dinamizmin e sektorit privat. Strategjia thekson se një numër i madh i programeve të ofruara në institucione të AAP janë tejet të vjetra, dhe për disa programe ka kërkesë tejet të vogël apo edhe nuk ka kërkesë fare në tregun e punës.

Sipas PSAK 2017-2021, shpenzimet totale për arritjen e objektivave të specifikuar për periudhën 5 vjeçare janë € 176,941,537. Nga kjo shumë, vetëm € 6,772,946 parashihet të ndahen për OS 6, që përbën

vetëm 3.9% të buxhetit të përgjithshëm. Nëse ndërlihdja e arsimit me tregun e punës konsiderohet si prioritet i lartë, është e logjikshme të pritët që një pjesë më e madhe e buxhetit të ndahet për këtë synim. Krahas kësaj, një qasje proaktive e sektorit privat për të zbatuar këtë strategji me sukses është kyçe, qoftë me qëllim të ofrimit të resurseve financiare për aktivitete të ndryshme në kuadër të objektivave, apo edhe duke ofruar të dhëna dhe komente për institucione bartëse.

Korniza legjislative

Në masë të madhe, Kosova ka një legjislacion gjithëpërfshirës që rregullon funksionimin e institucioneve arsimore në vend. Për qëllime të këtij publikimi, vlen të theksohen disa nga ligjet kryesore që rregullojnë këtë fushë.

Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës rregullon edukimin parauniversitar për nxënësit dhe individët që i përkasin niveleve 0 deri 4 sipas Standardeve Ndërkombëtare për Klasifikimin e Arsimit (ISCED), të adoptuara nga UNESCO. Sipas këtij ligji, nivelet e arsimit para-universitar janë:

- Niveli 0: Arsimi parashkollor
- Niveli 1: Arsimi fillor që zgjat 5 vite
- Niveli 2: Arsimi i mesëm i ulët që zgjat 4 vite
- Niveli 3: Arsimi i mesëm i lartë që zgjat 3 vite, varësisht kurrikulumit të përcaktuar
- Niveli 4: Arsimi profesional post sekondar që zgjat 1 ose 2 vite, varësisht kurrikulumit të përcaktuar
- Programe të mësimi gjatë gjithë jetës për të rritur

Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional rregullon sistemin e arsimit dhe aftësimin profesional në vend, dhe themelon dy agjenci të ndryshme: (1) Agjencinë për arsim dhe aftësim profesional dhe për të rritur, dhe (2) Këshillin për arsimin dhe aftësimin profesional dhe për të rritur. Ligji parasheh edhe përfshirjen e sektorit privat në institucione të arsimit dhe aftësimin profesional. Gjithashtu, ligji parasheh zhvillimin e kurrikulave dhe standardeve të profesionit, duke sqaruar shkurtimisht detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve kryesore.

Ligji për Kualifikimet Kombëtare themelon Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, një përbërës tejet i rëndësishëm i reformave në sistemin arsimor dhe të punësimit në Kosovë. Përgjegjësia operative mbi KKK ndahet ndërmjet Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (në çështje që kanë të bëjnë me arsimin profesional), Ministrinë e Arsimit (në arsimin e përgjithshëm), dhe Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (në akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë).

AKK mban dhe përditëson regjistrim e kualifikimeve brenda KKK, që publikohen në ueb faqen zyrtare të AKK, dhe janë të qasshme për të gjitha palët e interesit. KKK poashtu përmban një listë të standardeve të profesionit që janë verifikuar nga AKK.

Ligji për Arsimin në Komunitet e Kosovës rregullon rolin e komuniteteve në sistemin arsimor në vend. Disa nga përgjegjësitë që u caktohen komuniteteve përmes ligjit përfshijnë: ndërtimin e objekteve arsimore, regjistrimi dhe pranimi i studentëve, punësimi i mësimitdhënësve dhe personelit tjetër, emërimi i drejtorëve të shkollave, pagesa e stafit menaxherial, trajnimi i edukatorëve, mbikëqyrja dhe vlerësimi i procesit arsimor etj.

PSAK thekson se jo të gjitha komunitetet kanë qenë në gjendje që në mënyrë të suksesshme të kryejnë detyrat dhe rolet e tyre pas decentralizimit të vitit 2009, meqenëse disa komunitete nuk kanë burimet financiare si dhe njohuritë dhe përvojën për të menaxhuar me institucionet arsimore.

Ligji për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës ka për synim të shërbejë si korniza kryesore për politikën mbi zhvillimin e arsimit dhe aftësimin për të rritur, si pjesë e konceptit të të nxënimit gjatë gjithë jetës. Ligji parasheh themelimin e institucioneve që ofrojnë arsim dhe aftësim për të rritur, kriteret për licencimin e institucioneve të tilla, si dhe regjistrimin e programeve të ndryshme.

Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës shërben si korniza kryesore legjislative për funksionimin e institucioneve të arsimit të lartë në vend. Ligji parasheh 4 kategori të arsimit të lartë bazuar në ECTS (Sistemi Evropian i Transferimit dhe i Akumulimit të Kredive), gjegjësisht:

- Niveli 1: studimet e nivelit bachelor prej 3-4 vitesh, me të cilat arrihen 180 apo 240 ECTS
- Niveli 2: studimet e nivelit master prej 1-2 vitesh, me të cilat arrihen 60 apo 120 ECTS
- Niveli 3: programe të studimeve të doktoratës me karakter akademik dhe hulumtues shkencor të pavarura
- Arsimim tjetër postsekondar që i përket niveleve 5-8 të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve

Vlen të theksohet se ligji ka qenë mjaft i debatuar mes institucioneve arsimore përgjatë këtyre viteve, për shkak dispozitave përkatëse që rregullojnë funksionimin dhe akreditimin e universiteteve dhe programeve. Në vitin 2016, Qeveria ka përgatitur një projektligj për amendamentimin e ligjit aktual për të adresuar një numër të shqetësimeve, por deri tani ligji nuk i është dërguar kuvendit. Gjithashtu, ligji parasheh edhe funksionimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e këtij institucioni. Kriteret për licencimin e universiteteve gjithashtu parashihen në ligj, dhe vlen të theksohet që pikërisht këto kritere kanë nxitur debat mes institucioneve private të arsimit të lartë.

Ndërlidhja e institucioneve arsimore me tregun e punës

Për një lexues që nuk është i fushës, sistemi aktual i arsimit mund të duket mjaft kompleks. Megjithatë, grafi në fund të kësaj faqeje ka për synim të paraqesë një pasqyrë më të qartë.


Pas përfundimit të shkollës së mesme të ulët (klasës së 9-të), nxënësit mund të zgjedhin se a dëshirojnë të vazhdojnë avancimin e tyre në arsim të mesëm të përgjithshëm (akademik) apo në shkollë të mesme profesionale. Nxënësit që kanë synim që më vonë të vazhdojnë studimet universitare, zakonisht regjistrohen në shkolla të përgjithshme (gjimnaze). Pas përfundimit të studimeve në këtë nivel, nxënësit hyjnë në maturën shtetërore si parakusht për regjistrim në institucione të arsimit të lartë. Në anën tjetër, studentët që regjistrohen në shkolla profesionale, pas përfundimit mund të vazhdojnë arsimin profesional terciar apo të regjistrohen në ndonjë universitet pas kryerjes së maturës shtetërore. Vlen të theksohet se ka një tendencë të madhe mes nxënësve të preferojnë regjistrimin në arsim të përgjithshëm, si rrjedhojë e perceptimit apo tendencës që ky drejtim ka më shumë gjasa që të sigurojë një "punë në zyrë". Faktikisht, rreth 50% e nxënësve regjistrohen në gjimnaze, përderisa kjo shifër arrin vetëm në 30% në shtete në fazë shumë më të avancuar të zhvillimit ekonomik krahasuar me Kosovën.

Niveli i arsimit	Numri i studentëve
Niveli parashkollor	27,508
Shkollë fillore dhe e mesme e ulët	263,779
Shkolla e mesme e lartë	43,776
Shkollat profesionale	42,600
Arsimi dhe aftësimi për të rritur	1,794
Arsimi i lartë	120,429

Institucionet e Arsimit të Lartë

Institucionet e Arsimit të lartë përfshijnë: universitetet, universitetet e shkencave të aplikuar, akademitë, kolegjet universitare, kolegjet, shkollat e larta profesionale dhe shkollat e larta teknike. Sipas legjislacionit në fuqi, institucionet e arsimit të lartë mund të ofrojnë programe akademike apo profesionale. Institucionet e arsimit të lartë licencohen nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ku vlerësimi i jashtëm i aplikimeve bëhet nga Agjencia Kosovare e Akreditimit.

Numri i përgjithshëm i studentëve në institucionet e arsimit të lartë në vitin 2015 ishte 122,000, sipas të dhënave të publikuara në PSAK. Për të vendosur këto të dhëna në kontekst, Kosova ka 20 institucione të arsimit të lartë për 1 milion banorë, dhe 6,669 studentë në këto institucione për 100,000 banorë, që paraqet **dyfishin e mesatares në BE**. Kjo edhe mund të jetë reflektim i qasjes së përgjithshme të



qytetarëve të Kosovës kundrejt arsimit, ku regjistrimi në universitete është shumë më i dëshirueshëm krahasuar me ndjekjen e shkollave profesionale. Veçanërisht shqetësuese paraqitet situata në Fakultetet e Ekonomisë dhe Juridikut, ku numri i studentëve duket se tejkalon kapacitetet e këtij institucioni, qoftë në aspekt të infrastrukturës fizike apo stafit.

- Mosrespektimi i standardeve të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë
- Mospërshtatja e programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës
- Prania e pamjaftueshme e punës kërkimore-shkencore në institucionet e arsimit të lartë
- Mos kompletimi i kornizës ligjore në arsimin e lartë
- Bashkëpunimi joefektiv ndërkombëtar në arsimin e lartë
- Proporcion i ulët dhe i pakënaqshëm staf/studentë
- Kapacitete të dobëta administrative dhe infrastrukturë jo adekuate
- Mungesa e një plani të financimit të bazuar në efikasitet dhe llogaridhënie

Analiza e Boshllëkut të Shkathtësive tregon se sektori privat ankohet për mungesën e planifikimit në nivel qendror sa i përket profileve të kërkuara në tregun e punës, që duhet të furnizohen nga institucionet e arsimit të lartë. Afërsisht gjysma e studentëve në këto institucione janë të regjistruar në shkencë shoqërore, administrim biznesi dhe juridik. Kapaciteti absorbues për këto profile në sektorin privat padyshim që është më i ulët se furnizimi.

Poashtu, vërehet nevoja për të përfshirë lëndë mësimore mbi këshillimet për zhvillim të karrierës në të gjitha fakultetet e universitetit. Kjo do t'i mundësonte studentëve të ndërtojnë një perspektivë më të mirë për punësim në të ardhmen.

Institucionet e Arsimit Profesional

Boshllëqet më të mëdha të shkathtësive në studimin e Odës Amerikane mbi këtë temë janë identifikuar në profile që duhet të ofrohen në shkolla profesionale. Kompanitë private, veçanërisht në sektorin e prodhimit, ballafaqohen me sfida të mëdha për

gjetjen e punëtorëve që mund të kryejnë punë teknike/profesionale në vend të punës. Kompanitë e ndërtimit dhe përpunuesit e metalit ankohen për vështirësi në gjetjen e punëtorëve me shkathtësi të saldimit, përderisa përpunuesit e ushqimit ankohen për mungesën e teknologëve si dhe profesionistëve për kontroll të cilësisë dhe sigurisë së prodhimit. Deri tani, sistemi i shkollave profesionale nuk ka arritur të ndjek sektorin privat sa i përket kërkesave për kadro të kualifikuara.

Ofruesit e AAP (formal dhe jo-formal)

- Shkollat e Arsimit Profesional, publike dhe private
- Qendrat publike të kompetencës,
- Institucionet profesionale post sekondare
- Qendrat e trajnimeve në kuadër të Ministrisë së Punës
- Institucionet tjera publike dhe private të arsimit dhe aftësimi profesional që ofrojnë arsim dhe aftësim formal dhe joformal

Për momentin në Kosovë janë rreth 60 shkolla të mesme profesionale dhe 4 qendra të kompetencës. Ueb faqja e Agjencisë Kombëtare të Kualifikimeve liston 33 standarde të profesionit, 140 profile të ndryshme dhe 60 kualifikime modulare. Si në sektorë tjerë, edhe sektori i AAP në Kosovë ballafaqohet me një numër të sfidave dhe shqetësimeve që duhet adresuar. PSAK liston disa nga këto sfida::

- Mospërshtatja e programeve të AAP-së me kërkesat e tregut të punës- të paktën 30% e shkollave profesionale ofrojnë profile me kërkesë shumë të vogël në treg
- Mekanizma të dobëta të sigurimit të cilësisë
- Mungesa e këshillimit dhe orientimit në karrierë
- Kornizë jo e kompletuar për standardet e profesionit
- Mungesa të mëdha të fondeve (veçanërisht në IAAP-të publike)
- Mangësi serioze në punën praktike dhe praktikën profesionale

- Mungesa e trajnimeve dhe prapavijës adekuate për stafin mësimdhënës
- Vështirësi në sigurimin e materialeve mësimore për AAP
- Mungesa e Kurrikulës Bërthamë për AAP
- Problemi i qëndrueshmërisë së qendrave të kompetencës dhe zhvillimi i mëtejshëm i tyre
- Mungesa e sistemit efikas të arsimimit për të rriturit

Studentët në shkolla profesionale ndodhen në një udhëkryq të karrierës së tyre në moshë shumë të re, dhe të pasurit një sistem të mirë që do të ndihmonte vendimmarrjen e tyre do të ishte i mirëseardhur jo vetëm për ta, mirëpo edhe në aspekt të krijimit të një fuqie punëtore me shkathtësi të kërkuara në sektor privat. Prandaj, është me rëndësi për institucionet e AAP të ofrojnë shërbime për këshillim karriere për studentët e tyre.

Zhvillimi i kurrikulave

Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, që fillimisht është adoptuar në vitin 2011 (dhe ndryshuar në vitin 2016), është dokumenti primar politik për zhvillimin e kurrikulave në arsimin parauniversitar në Kosovë. Duke pasur parasysh qasjen bazuar në kompetenca, Korniza e Kurrikulimit të Kosovës ka definuar 6 kompetenca që studentët duhet t'i arrijnë pas përfundimit të studimeve parauniversitare.

Kompetencat kyçe të Kornizës Kurrikulare

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
- Kompetenca e të menduarit
- Kompetenca e të mësuarit
- Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis
- Kompetenca personale
- Kompetenca qytetare

Zhvillimi i kurrikulave në harmoni me nevojat e sektorit privat është tejet i rëndësishëm për të krijuar urë lidhëse me sektorin privat dhe për të rritur gjasat

për punësim të studentëve. Agjencia Kombëtare e Kualifikimeve është përgjegjëse për akreditimin e institucioneve të AAP dhe vërtetimin e kualifikimeve. Procesi i hartimit të kurrikulave, veçanërisht në sektorin e AAP, duhet të jetë i bazuar në kërkesa dhe në përputhje me nevojat e sektorit privat. Megjithatë, një gjë e tillë nuk ka ndodhur deri tani.

Një numër i institucioneve të AAP veçse kanë themeluar borde industriale, që duhet të shërbejnë si mekanizma për konsultim me sektorin privat dhe si mekanizma për marrjen e inputit për draftim të programeve në përputhje me nevojat e tregut. Kompanitë e sektorit privat duhet të ndërtojnë bashkëpunim më të mirë me institucione të tilla dhe duhet të kontribuojnë në punën e bordeve.

Fokusi në Analizën e Boshllëkut të Shkathtësive

Analiza e Boshllëkut të Shkathtësive e Odës Amerikane ka vënë në pah shkallën e mospërputhjes mes asaj çka punëdhënësit kërkojnë dhe asaj se çka arrijnë të gjejnë tek punëtorët sa i përket shkathtësive dhe kompetencave. Disa nga të gjeturat kryesore janë:

- Në masë të madhe, bizneset nga sektorët e prodhimit dhe shërbimeve raportojnë më shumë vështirësi në gjetjen e punëtorëve me shkathtësitë e nevojshme, krahasuar me sektorin e tregtisë. Kjo për arsye se kompanitë në këta sektorë kërkojnë shkathtësi më specifike të nevojshme për atë industri specifike, dhe jo shkathtësi të përgjithshme që mund të jenë të vyeshme nëpër gjithë sektorët.
- Kompanitë e anketuara tregojnë se ndikimi më i madh i boshllëkut është rritja e shpenzimeve operacionale, si rezultat i nevojës së organizimit të trajnimeve të specializuara për punëtorë të ri në mënyrë që të njëjtit të fitojnë kompetenca për kryerjen e detyrave të tyre. Në aspekt të shkathtësive që punëdhënësit në këtë sektorë kërkojnë tek punëtorët e ri, 3 opsionet e zgjedhura më së shpeshti janë: shkathtësitë teknike në linja të prodhimit, shkathtësitë fizike/manuale dhe shkathtësitë e buta.
- Është vërejtur një tendencë mes kompanive të kërkojnë diploma universitare edhe për profile

që më shumë u përshtaten kandidatëve me diplomë të shkollimit profesional. Kjo mund të shkaktojë që situata ku shkollat profesionale shihen vetëm si alternativë të përkeqësohet.

- Boshllëku i shkathtësive ndikon në konkurrueshmërinë e bizneseve në nivel vendor dhe ndërkombëtar, si rezultat i humbjes së efikasitetit dhe rritjes së kostove operacionale. Bizneset kryesisht organizojnë trajnime në vendin e punës për të adresuar boshllëqet e identifikuar. Kompanitë në sektorin e prodhimit janë më të prira të ndajnë fond të veçantë për trajnimin dhe zhvillimin e punëtorëve.
- Koha e nevojshme që një punëtorë i ri të fitojë kompetenca të plota mbi detyrat e tij/saj është më e gjatë në sektorë të shërbimeve dhe prodhimit, gjë që nënkupton se këta sektorë do të ballafaqohen me kosto më të larta për trajnimin e punëtorëve të tyre.
- Një pjesë e madhe e përgjegjësisë për boshllëkun e shkathtësive i atribuohet institucioneve arsimore dhe politikëbërësve në këtë fushë. Ndërtimi i urave të bashkëpunimit mes institucioneve arsimore dhe sektorit privat është i domosdoshëm
- Bizneset në masë të madhe besojnë se kurrikulat arsimore zhvillohen pa marrë në konsideratë kërkesat e tyre për fuqi punëtore. Shumë pak respondentë theksojnë se konsultohen nga ana e institucioneve sa i përket nevojave të tyre për fuqi punëtore.
- Arsimit dhe aftësimi profesional ka nevojë për reformë thelbësore. Boshllëqet më të mëdha në anketë janë identifikuar për shkathtësi që do të duhej të fitohen në institucione të tilla, si dhe numri më i madh i punëve të reja të krijuara pritet të jenë në profile që i përshtaten institucioneve të arsimit profesional, gjë që edhe më shumë shton nevojën që t'i kushtohet rëndësi më e madhe kësaj shtylle të sistemit arsimor. Duhet të punohet në ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e arsimit dhe aftësimi profesional në mesin e nxënësve të shkollave të mesme të ulëta dhe prindërve të tyre

- Hartimi dhe aprovimi i standardeve të profesionit mund të përmirësojë situatën dhe të ndihmojë në uljen e boshllëkut të shkathtësive.
- Respondentët janë në përgjithësi optimistë për të ardhmen, ku shumica e tyre theksojnë se kanë plane për të rritur numrin e punëtorëve gjatë dy viteve të ardhshme.

Sistemi dual i arsimit në Gjermani

Siç u theksua deri tani, shumë nga boshllëqet e identifikuar lidhen me profile të ofruara në institucione të AAP. Gjermania dhe Zvicra kanë arritur të krijojnë një sistem efektiv për tranzicionin e të rinjve nga shkollat në vendin e punës.

Ky sistem dual ka ndihmuar në krijimin e një ure të fortë lidhëse mes sistemit arsimor dhe tregut të punës, dhe si rezultat, sot Gjermani ka një ndër normat më të ulëta të papunësisë në mesin e të rinjve në Bashkim Evropian. Programi gjerman i stazhit të punës për nxënës quhet "sistem dual" për faktin se trajnimi për nxënës jepet edhe në kompani (në vend të punës) edhe në institucione publike për arsim profesional (në shkollë). Përmes këtij sistemi, kompanitë përfitojnë fuqi të shkathtë punëtore përmes stazhit të nxënësve me një kosto të ulët. Stazhierët përfitojnë një pagë modeste (krahasuar me pagën e punëtorëve të rregullt), dhe trajnohen specifikisht për të plotësuar nevojat e kompanisë respektive. I gjithë sistemi i AAP ka burime të mjaftueshme financiare, falë kontributeve si nga sektori publik, ashtu edhe nga sektori privat.

Stazhi i punës në sistemin dual të arsimit zgjatë rreth 3 vite, ku stazhierët-nxënës kalojnë 3 ditë të javës në vend të punës, dhe ditët e mbetura në shkollën profesionale. Investimet në këtë program nga perspektiva e punëdhënësit mbulojnë falë produktivitetit të shtuar të të punësuarve në vendin e punës. Kostoja për funksionimin e këtij sistemi dual pak a shumë është e ndarë në mënyrë të barabartë mes sektorit publik dhe privat. Vlen të theksohet se afro 2/3 e fuqisë punëtore në Gjermani dalin nga sektori i institucioneve të arsimit dhe aftësimi profesional, ku puna profesionale vlerësohet tej mase. Një gjë e tillë nuk mund të thuhet për Kosovë, ku shpeshherë shkolla profesionale shihen si opsion i dytë për shumicën e nxënësve.

Zhvillimi i standardeve të profesionit

Procesi i hartimit të standardeve të profesionit në Kosovë duhet të vazhdojë. Deri tani, numri i standardeve të profesionit të zhvilluar në Kosovë është i vogël, dhe ky proces duhet përshpejtuar. Standardet e profesionit kanë për synim të shërbejnë si verifikim se personi në fjalë i zotëron shkathtësitë për profilin e kërkuar në kompani.

Përgjatë viteve të fundit shteti i Indisë ka bërë përparim të madh në përgatitjen e fuqisë punëtore si burim i konkurrueshmërisë në ekonomi globale. Zhvillimi i shkathtësive në Indi është i lidhur ngushtë me funksionimin e Këshillave Sektoriale për Shkathtësi, trupa autonome të udhëhequra nga vetë industria që janë përgjegjës për hartimin e standardeve të profesionit dhe pakove të kualifikimeve. Tani ekzistojnë 37 këshilla sektoriale në një numër të industrive, secila përgjegjëse për hartimin e standardeve në fushat respektive. Ky proces ka ndihmuar në uljen e boshllëkut të shkathtësive në masë të madhe, dhe ka lehtësuar procesin e krijimit të një fuqie punëtore të gatshme për të konkurruar në tregun global.

Rrjedhimisht, adoptimi i një koncepti të ngjashëm në Kosovë, ku Këshillat Sektorial për Shkathtësi (të përbëra nga bizneset e fushës) do të zhvillojnë standardet e profesionit, mund të ndikojë në reduktimin e hendekut të shkathtësive.

Konkluzionet

Padysim se adresimi i sfidave në sektorin arsimor nuk është i lehtë. Ka shumë institucione të përfshira në proces, dhe çfarëdo reforme e ndërmarrë duhet të jetë e menduar mirë dhe e planifikuar në aspekt afatgjatë. Fatmirësisht, ka shumë shtete që janë treguar të suksesshme në ndërlidhjen e sektorit privat me institucione arsimore, që mund të merren si referencë për Kosovën gjatë hartimit të strategjive në fushën e arsimit

Funksionalizimi i bordeve industriale (në institucione të arsimit të lartë dhe atij parauniversitar) mund të ndihmojë në bashkëpunim më të mirë mes institucioneve arsimore dhe sektorit privat. Bordet e tilla industriale mund të jenë veçanërisht të rëndësishme për shkolla profesionale. Megjithatë, themelimi dhe funksionimi i mirëfilltë i këtyre bordeve varet shumë nga një qasje proaktive e vetë

bizneseve. Bizneset duhet të përfshihen gjatë hartimit të kurrikulave, në mënyrë që të kontribuojnë në zhvillimin e një fuqie punëtore që reflekton nevojat e sektorit.

Procesi i zhvillimit të standardeve të profesionit duhet të vazhdojë dhe të përshpejtohet. Shembulli i Indisë tregon se si sektori privat mund të përfshihet në këtë proces, nga i cili në fund përfitojnë vetë bizneset. Këshillat Sektorial të Shkathtësive në Indi kanë mundësuar zhvillimin e mijëra standardeve të profesionit, që e bën punësimin e punëtorëve me shkathtësitë dhe njohuritë e kërkuara shumë më të lehtë. Një përfshirje më e madhe e sektorit privat do të korrë suksesin e dëshiruar, duke qenë se bizneset më së miri i dinë shkathtësitë që nevojiten për profile të ndryshme.

Shkollat profesionale (institucionet AAP) duket të jenë në disavantazh krahasuar me gjimnazet sa i përket preferencës në mesin e të rinjve që përfundojnë shkollën e mesme të ulët. Shkollat profesionale shpeshherë shihen si zgjedhje e dyte në rastin se nxënësit nuk pranohen në gjimnaze. Pavarësisht kësaj, duhet theksuar se vendet e reja të punës pritet që më së shumti të krijohen për profile që më së shumti i përshtaten të diplomuarve nga IAAP. Institucionet duhet punuar në ngritjen e vetëdijes së prindërve dhe nxënësve të nivelit të shkollës së mesme të ulët, mbi rëndësinë e ndjekjes së shkollave profesionale si opsion karriere.

Gjithashtu, institucionet arsimore duke përfshirë edhe institucionet e AAP duhet të krijojnë dhe funksionalizojnë zyret për këshillim në karrierë, në mënyrë që të informojnë studentët mbi potencialet e fushave të caktuara pas diplomimit. Ministria e Arsimit dhe institucionet tjera relevante mund të shikojnë dhe mësojnë nga shtete tjera që kanë qenë të suksesshme për zhvillimin e sistemit të këshillimit në karrierë.

Lista e shkurtesave

AAP	Arsimi dhe aftësimi profesional
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
PSAK	Plani Strategjik për Arsimin në Kosovë
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
KKK	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve
ECTS	Sistemi Evropian për Transfer dhe Akumulim të Kreditave
IAAP	Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional